



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:093901

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05345608

KE.nr.652/22
(Lidhja C.nr. 487/10; C.nr.29/16)

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 20.02.2024 në GJYKATËN KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë,
Departamenti për Çështje Ekonomike

Gjyqtari:
Florent Zeqiri

Zyrtare Ligjore:
Miranda Murturi

Paditësi: Kompania Rajonale e Ujësjetës Radoniq Sh.A.,

E paditura: Komuna e Gjakovës – Fondi për rregullimin e tokave

Lënda e kontestit: borxh nga ekstrakti afarist.

Filloi në 11:00
Seanca është publike

Gjyqtari e hap seancën, publikon lëndën e shqyrtimit dhe përbërjen e gjykatës.

Palët pa vërejtje.

Konstatohet se prezent janë:

Për paditësin: M.Z., sipas autorizimit

Për të paditurin : V.SH., përfaqësuese ligjore, tek e paditura, sipas autorizimit.

Përfaqësuesi i paditësit deklaron: lidhur me borxhin i cili është objekt i kësaj procedure, e paditura e ka përmbushur ne tërësi obligimin, fakt ky që vërtetohet nga ekstrakti i librave te

kontabilitetit të cilën në kopje të mjaftueshme e dorëzoj në këtë seancë, andaj kërkojmë nga gjykata që të konstatohet tërheqja e padisë.

Përfaqësuesja e të paditurës deklaron: nuk e kundërshton tërheqjen e padisë, megjë të bindur e bën ekstrakti i librave të kontabilitetit të pranuar nga pala paditëse në këtë seancë.

Pas kësaj gjykata në kuptim të nenin 261 par .2 të LPK-së merr këtë

AKTVENDIM

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit KRU Radoniqi Sh.A., Gjakovë kundër të paditurës Komuna e Gjakovës me objekt kontesti borxh nga ekstrakti i librave afaristë, lënda e identifikuar me shenjën KE.nr. 652/22 (Lidhja C.nr. 487/10; C.nr.29/16).

Palët një zëri deklarojnë se nuk kërkojnë që lidhur me tërheqjen e padisë të nxirret aktvendim i veçantë.

Ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta e ankesës.

Përfundoi në orën 11:15

Palët prezente e lexuan dhe e nënshkruan procesverbalin pa vërejtje.

Paditësi

I Padituri

Vërtetojnë:

Zyrtarja Ligjore

Gjyqtari